



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 16 mars 2022 në mbledhjen e VIII-të (tetë)-e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.

E thirrur në kërkesë të 17 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, nr.prot. 01-060/01-0018120/22 të datës 10 mars 2022, me pikën e rendit të ditës;

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, përveç z.Valon demolli dhe z.Gazmend Islami, të cilët munguan.

Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive (DBF, DPZHE, DPUMM, DSHPMSh, DBPZHR, DA, DSHMS DI)

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale dhe më gjerë, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i ditës

➤ Ndarja e mjeteve buxhetore për pako ushqimore dhe higjienike për familjet me asistencë sociale dhe në nevojë

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera theksoi, në bazë të listës së nënshkrimeve të pranishëm në sallë janë 33 anëtar/e të Kuvendit ndërsa për momentin mungojnë 2, andaj kuorumi ekziston për të vazhduar me mbledhjen.

Sot jemi në këtë mbledhje të jashtëzakonshme, mbledhja e tetë e mandatit të shtatë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mbledhje kjo e thirrur me iniciativën e Grupit të këshilltarëve të LDK-së, kërkesë kjo e bashkëngjitur me 17 nënshkrime me pikën përkatëse të rendit të ditës.

Për këtë iniciativë është mbajtur edhe mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa në të cilën është diskutuar gjerë dhe gjatë dhe i vetmi qëllim ka qenë mënyra se si të gjenden mjetet buxhetore për financimin e iniciativës së marrë nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së, mbledhje nga e cila është votuar unanim (me 9 vota për) dhe i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim, andaj kush është që të vazhdohet të punohet me këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri (me 33 vota për) mbështetet që të vazhdohet me punë në këtë mbledhje sipas pikës përkatëse të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, tani fillojmë me punë sipas rendit të ditës dhe fjalën ja jap iniciuesit të kësaj seance.

z.Qëndrim Softolli, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, më lejoni që të paraqesë qëndrimin e Grupit të këshilltarëve të LDK-së me mbështetjen edhe të asamblistëve tjerë lidhur me pikën e vetme të rendit të ditës të kësaj seance të jashtëzakonshme.

Nisur nga rrethanat e krijuara së fundmi si pasojë e gjendjes së rënduar ekonomike dhe sociale si dhe qëndrimit duarkryq nga ana e përgjegjësve institucional nga niveli qendrorë dhe lokal për t'u përballuar me situatën e krijuar si rrjedhojë e rritjes së vazhdueshme të çmimeve që përbëjnë pakon esenciale familjare, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së mbështetur edhe nga Grupet dhe individët e subjekteve tjera të AAK-së dhe OBKD të cilët i falënderojmë, kemi marrë iniciativë për thirrjen e kësaj seance të jashtëzakonshme për të propozuar ndarjen e mjeteve buxhetore për pako ushqimore dhe higjienike për familjet me asistencë sociale dhe në nevojë.

Me që jemi në fillim të vitit buxhetor të Komunës dhe mjetet e parapara në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere po thuajse të gjitha janë të pashpenzuara, që nga kjo kategori të ndahen 60,000.00€ të cilat do të përdoren për sigurimin e pakove ushqimore dhe higjienike për të gjitha familjet në listën e asistencës sociale dhe familjet tjera në nevojë. Jemi të vetëdijshëm se kjo shumë është e pamjaftueshme, bazuar në gjendjen e rënduar ekonomike me të cilën po përballen shumë familje në Komunën tonë, mirëpo kemi marrë këtë iniciativë në mënyrë që sa do pak të ndikojmë në zbutjen e kësaj gjendje.

Në buxhetin e Komunës së Podujevës të aprovuar muaj më parë, te kategoria subvencione dhe transfere janë të miratuara 960,000.00€, andaj konsiderojmë se shuma e propozuar nga ne nuk e rrezikon planin e subvencionimit nga Komuna dhe stabilitetin financiar të Komunës.

Situata në të cilën ndodhemi më së paku ka të bëjë me germa dhe simbole, prandaj kërkojmë mbështetjen e gjithsecilit prej juve duke mundësuar jetësimin e kësaj nisme dhe sa më parë të implementohet pasi që edhe jemi në prag të muajit të shenjtë të Ramazanit.

Ne e dimë që kjo shumë e propozuar nuk i'u përgjigjet të gjitha nevojave dhe kërkesave dhe të këtyre kategorive, andaj në cilësinë e propozuesit mbështesim çdo iniciativë për rritjen e shumës buxhetore dhe natyrisht jemi të lumtur nëse kjo ndodh.

Për fund, nëse kjo iniciativë merr mbështetjen e Kuvendit, me qëllim të mbikëqyrjes dhe implementimit sa më të drejtë të procesit rreth shpërndarjes së pakove, kërkojmë krijimin e një komisioni ad-hoc në përbërje miks prej anëtarëve të Kuvendit të Komunës, i cili do të mbikëqyrë procesin dhe do të hartoj raport me të cilin në fund të procesit do t'i raportoj Kuvendit të Komunës.

znj.Adelinë Stublla, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, e përkrahim dhe mbështesim çdo iniciativë që merret për të mirën e qytetarëve, kështu që jemi në dijeni se është një numër i madh i këtyre personave në Komunën e Podujevës që janë me asistencë sociale, rreth 900 familje, kështu që ne kërkojmë të specifikohet se në cilat kategori të subvencioneve t'i marrim mjetet buxhetore pasi që të mrren nga subvencionet e shëndetësisë do t'jua marrësh subvencionet pacientëve me sëmundje kronike kjo është e pashpjegueshme, pastaj nga bursat e studentëve është diçka që është sociale, e mos të flasim për marrjen e subvencioneve në bujqësi që është diçka afatgjate dhe profitabile.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, edhe ne si Grup mendojmë që edhe pse nuk është zgjidhje afatgjate jemi për propozimin e ndarjeve të mjeteve për familjet në nevojë, mirëpo është mirë që propozuesi së bashku dhe në koordinim me Ekzekutivin e Komunës të vendosin se prej cilave kode buxhetore të merren mjetet dhe pastaj të hedhet në votim dhe të miratohet me vendim. Natyrisht se as ne nuk e mbështesim që këto mjete të merren nga subvencionet në shëndetësi dhe nga subvencionet e parapara për bursa për student.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, të debatosh për një pikë të rendit të ditës siç e kemi tani që ka të bëjë me gjendjen e rënduar sociale më bënë të deklaroj në këtë foltore të Kuvendit mbështetjen e pa rezervë të ndarjes së mjeteve buxhetore për këtë kategori që po diskutohet. Unë çdo herë e kam pas vullnetin dhe gatishmërinë të mbështesë çdo iniciativë që lehtëson jetën e qytetarëve dhe e vërteta është se këtë mbështetje u'a kam deklaruar edhe iniciuesve të kësaj iniciative pavarësisht që nënshkrimi im nuk gjendet në listën e nënshkrimeve sepse ditën e mbledhjes së nënshkrimeve unë dhe familja ime kishim rast vdekje, dhe nga këtu shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë ata që ndan dhimbjen me neve e në veçanti falënderoj disa prej kolegëve të Kuvendit që ishin për ngushëllime në familjen tonë.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, familjet me asistencë sociale gjithmonë duhet të përkrahen në çdo formë të mundshme. Duhet të jemi të përkushtuar t'i shfrytëzojmë të gjitha resurset e mundshme në mënyrë që t'iu ofrojmë kushte të barabarta edhe kësaj shtrese të shoqërisë tonë.

Sfidë për momentin është rritja e çmimeve të produkteve ushqimore dhe jo vetëm, dhe për këtë shkak ne si Komunë do të duhet t'iu dalim në ndihmë sa do pak në mënyrë që t'jua lehtësojmë edhe këtë barrë tejet të rëndë këtyre familjeve për shkak të rritjes eksponiale të çmimeve. Mundësisht Komuna jonë t'i mbështesë me pako ushqimore dhe higjienike këto familje që janë me asistencë sociale, pasi që është obligim moral dhe ligjor që t'u gjendemi në ditë të vështira secilit qytetar.

z.Adnan Zymeri, theksoi, sot kam kënaqësinë e veçantë dhe ndihem shumë i nderuar që fjalimin tim të parë në mandatin tim të dytë në këtë Kuvend po e lidhë duke arsyetuar dhe duke dhënë mbështetje një iniciative për t'i ndihmuar sado pak atyre që kanë nevojë shumë.

Është krejt normale që në situata të jashtëzakonshme derivojnë edhe rezultate të jashtëzakonshme si në aspektin ekonomik edhe në aspekte tjera të jetës, e në situata të tilla kur bota është e mobilizuar në veprim dhe kur janë ri definuar prioritetet, ne nuk na takon roli i vëzhguesit, por me iniciativa të këtilla sikurse që është kjo, ne si Kuvend i Komunës tregojmë që nuk jemi vëzhgues dhe që prioritet mbi prioritetet është mirëqenia e qytetarëve.

Për të rikujtuar pak nga memorja institucionale, ashtu siç është përballuar e gjithë bota edhe ne si Komunë nuk është larg që kemi kaluar një sfidë epidemiologjike për të cilën Kuvendi pati miratuar me unanimitet ish propozimin e ish Kryetarit Rudari për ndarjen e mjeteve buxhetore për familjet në nevojë, gjë për të cilën kam vlerësuar dhe vlerësoj konstruktivitetin e partive politike të opozitës së atëhershme. Ngjashëm me sfidën që kaluam, inflacion është epidemia financiare që ka goditur shportën e secilës familje në vendin tonë, rrjedhimisht edhe Komunën e Podujevës dhe me të cilën po përballemi tani, situatë e rënduar atëherë situatë e rënduar tani, bashkë ishim atëherë bashkë do të duhej të jemi tani.

Për fund, parimi i shumë përmendur në ekonomi është që gjithmonë kërkesat janë më të mëdha se sa burimet e disponueshme, kjo është edhe arsyeja përse e kemi qeverisjen lokale vetëm për të vendosur për kërkesat prioritare nën kushtet e kufizueshmërisë së burimeve, dhe në këndvështrimin tim asgjë nuk ka më prioritare dhe më njerëzore se t'jua sigurojmë edhe për disa ditë bukën e gojës atyre që më së shumti kanë nevojë, prandaj ju ftoj që ta mbështesim këtë iniciativë dhe deri në iniciativa të tjera qëllimmira kemi kohë mjaftueshëm t'iu kthehemi flamujve politik.

z.Ragip Fetahu, theksoi, kur po dëgjoj diskutimet, e sidomos ato të Grupit të LDK-së më krijon përshtypjen se ne jemi në gjendje lufte, krizë, tmerr, luftë, trazira, ndërsa nuk e di sepse së pari secili nga ne teorikisht mund ta krijoj diçka dhe mund të ngritë diçka, dhe po ashtu nuk e di se sa individ apo sa familje i keni dërguar ju tek Ekzekutivi i Komunës, që vërtetë janë në nevojë dhe apo që i'u është ndihmuar atyre dhe nuk e di a e keni dërguar ndonjë, prandaj problemet duhet të zgjidhen në mënyrë praktike jo vetëm teorikisht dhe jo të orientohen gjërat vetëm në baza politike, unë të paktën

një herë në javë dërgoj raste tek Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS dhe drejtori është shumë kooperativ dhe bashkëpunues e që të gjitha ato raste që i drejtohen kësaj Drejtorie, drejtori i'u përgjigjet me kënaqësinë më të madhe.

E di që DSHMS bënë një punë të madhe me 946 familje të cilat janë raste sociale në Komunën tonë e që në vazhdimësi ato familje ndihmohen me pako dhe me gjëra të ndryshme për të cilat ata kanë nevojë dhe kërkesat të cilat parashtrohen, jo vetëm nga rastet sociale, por edhe nga të tjerët që kanë nevojë momentale atyre i'u përgjigjet pozitivisht nga qeverisja aktuale komunale. Mendoj se për situatën dhe amullinë që po krijohet tani është më tepër politike se sa t'i jepet konotacion i ndihmesës momentale për qytetarët, kjo nuk duhet të bëhet dhe nuk duhet të lejohet dhe në asnjë mënyrë nuk bënë të shikohet nga ky këndvështrim kjo pikë.

Është mirë që ne të ndihmojmë, unë jam për të ndihmuar, madje unë personalisht sa për informimin e juaj i'u ndihmoj në vazhdimësi njerëzve që kanë nevojë, por jo të politizohet, jo të ngritën mbi baza politike çështjet të cilat janë të ndjeshme për shoqërinë. Nuk e di se sa keni shkuar dhe sa e keni ndarë kohën për të shkuar në DSHMS dh të kërkonit informacione se çka është planifikuar për muajt e ardhshëm e që unë jam në dijeni se ka mbështetje të madhe për këto kategori, ka pako të cilat janë dhe do të shpërndahen për këto kategori si dhe ka mbështetje të ndryshme nga donatorë të ndryshëm që i'u ofrohen këtyre njerëzve, prandaj është mirë që ne të ecim me këmbë për tokë dhe të mos shfrytëzojmë gjendjen apo rrethanat e krijuara ekonomike lokale momentale dhe t'i shfrytëzojmë për qëllime tona personale e politike.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, po flitet që të mos përfshihen flamujt politik por unë po shohë se në momentin që po dalin opozita në foltore po etiketon se dikush është asistent e gjëra tjera, por nuk është mirë sepse qëllimi i thirrjes së kësaj seance dihet dhe ju falënderoj që e keni thirr sepse qëllimi është shumë i mirë, por të mos vazhdohet me sulme.

Ne jemi në dijeni se mirëqenia sociale ekonomike është shumë e nevojshme për një qeverisje të mirë që populli të jetë i lumtur, por duhet pasur parasysh se a po dëshirojmë ta ndihmojmë popullin në periudhë afatshkurtër apo afatgjatë sepse është mirë të specifikohet se ku po dëshirohet të merret shuma prej 60,000.00€ e që nëse i marrim nga bujqësia atëherë unë mendoj se më mirë është të japim subvencion njerëzve që janë të interesuar të merren me bujqësi dhe të bëjmë zgjidhje afatgjate. Po ashtu nga bursat nuk bënë të preket buxheti sepse do të de-motivonte nxënësit dhe studentët, andaj unë kam të drejtë të shohë se nga cila kategori po mendohet të merren ato mjete edhe pse unë personalisht jam që shuma e propozuar prej 60,000.00€ të rritet sepse nuk është e mjaftueshme dhe ndihma duhet të jetë më e madhe, madje kur të gjithë bashkërisht jemi të mendimit që të ndihmohen qytetarët, përse të mos i vendosim edhe pagat tona të ardhshme që marrim si anëtar të kësaj asambleje dhe t'ia shtojmë shumës së propozuar për ndihmë me subvencion për familjet në fjalë.

Gjithashtu kërkoj që të formohet komisioni ashtu siç u cek në hyrje të kësaj mbledhje nga kolegët në mënyrë që të shohë se sa do të jetë transparent ndarja e këtyre pakove sepse e dimë që në kohën e pandemisë janë keqpërdorur subvencionet për maska dhe gjëra të tjera nga ish qeverisja e kaluar.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk e pata ndërmend por më bënë të marrë fjalën dy parafolësit.

Nga sa dëgjova nga propozuesi i kësaj seance në një prej pasuesve u deklarua që nuk kemi të bëjmë me germa politike, por krejt kjo një simbolikë që kemi përpara një diçka që është duke e rënduar qytetarin dhe kur është karshi situatave të palakmueshme, gjegjësisht nëse mund ta quaj situatë pandemike e rritjes së çmimeve në Kosovë, dhe vështirësi për qytetarin mesatar që të mund t'i bëjë ballë kësaj, kurse në anën tjetër tërë këto dit pjesa dërmuese qoftë e shkrimeve qoftë e shqiptimeve kanë qenë fjalët vaj, miell, grurë, refugjatë, krizë energjetike, e të tjera të ngjashme e që vërtetë është një “bombardim” i drejtë në zhgënjimin e qytetarëve në situatën që ndodhemi.

U fillu paksa të politizohet kjo çështje, jo fajtor ai jo fajtor ky, mirëpo ne as që nuk kërkuam fajtorin sepse fajtorët dihet kush është dhe kush i dërgon tek vendi ku matet faji e që duhet të punohet në atë drejtim që të dërgohen atje, dhe nëse dikush përmend dhe gjen fajtorët e në anën tjetër nuk vepron asgjë, në radhë të parë bëhet bashkëfajtor me ata.

Kolegu parafolës z.Ragip Fetahu gjatë diskutimit të tij u drejtohej me pyetje kolegëve asambleistë nga radhët e LDK-së se sa njerëz i keni dërguar tek Ekzekutivi i Komunës, jo i nderuar ne nuk jemi këtu që të dërgojmë njerëz tek Ekzekutivi por jemi për të marrë vendime të cilat duhet t'i zbatoj pastaj Ekzekutivi i Komunës, pra ky është roli i Kuvendit dhe nëse ndokush mendon se roli i Kuvendit është që të marrim ndokënd dhe ta dërgojmë tek Ekzekutivi e ka gabim sepse ne i kemi institucionet tona të cilat duhet të veprojnë karshi përgjegjësive që kanë, punë e ndarë është ajo e Kuvendit në këtë rol. Ndërsa përshtypja tjetër që u bë nga kolegu parafolës z.Xhevdet Maloku i cili përmendi flamujt partiak e që e përmendi edhe një kolegë i imi nga subjekti politikë LDK, por që zotëri Maloku bëri një lloj dileme që nëse ky propozim vendim kalon atëherë ku të gjenden mjetet buxhetore, kurse pas tri-katër fjalive e thotë që unë jam i mendimit të shtohet shuma, atëherë i nderuar kur ti kërkon të specifikohet ku të merren mjetet dhe në të njëjtën kohë propozon të rritet shuma, përse nuk e specifikon ti se ku të merren, dhe krejt në fund zotëri Maloku doli në çështjen e pagesës së këshilltarit e që nuk është qëllimi i kësaj seance.

z.Ragip Fetahu, theksoi, i nderuari zotëri Çunaku nuk e di a e keni lexuar Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e një asamblisti sepse aty ceket shumë qartë dhe në pika të trasha thuhet që detyra dhe përgjegjësia e një asamblisti është identifikimi i problemeve dhe adresimi i tij qoftë në Kuvend qoftë në adresat përkatëse ku ai problem mund të zgjidhet, andaj në këtë rast përfshirë edhe këto rastet sociale ku ne kemi obligim dhe përgjegjësi e sidomos prej zonës prej nga ju vini (i drejtohet z.Naim Çunakut) i dini dhe i njehni njerëzit të cilët kanë nevoja ose vështirësi momentale sociale e të cilët mund t'i dërgoni tek Ekzekutivi i Komunës për çka nuk jua mohon e as ndalon askush.

z.Naim Çunaku, përgjigje parafolësit, theksoi, për Ligjin e vetëqeverisjes lokale, Statutin e Komunës, Rregulloret dhe gjitha Ligjet që janë mbi 78 të tilla që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me pushtetin vendor i jep të drejtë vetit të them se i kam konsultuar, ndërsa ajo që ju zotëri Fetahu po pretendon se ne duhet të hulumtojmë raste dhe t'i paraqesim para Ekzekutivit, ne rrëshqasim nga pozicioni jonë si anëtar të Kuvendit të Komunës.

Të gjitha shqetësimet e qytetarëve dhe besimin që kemi marrë nga ata e kemi vendin që është Kuvendi i Komunës t'i debatojmë dhe për ata jemi që këtu të marrim vendime, kurse përgjegjësia për ekzekutimin e tyre është diku tjetër, e Ekzekutivit të Komunës, është e njeriut që është zgjedh drejtpërdrejt me votë qytetare po sikurse ne si anëtar të Kuvendit, pra është Kryetari i Komunës, dhe ne si Kuvend në bashkëpunim me Ekzekutivin duhet të gjejmë më të mirën për një qeverisje të mirë dhe lehtësim të jetës së qytetarëve. Nuk i ngatërroj unë kompetencat që na janë përcaktuar dhe jam goxha i matur, por që kam hasur edhe këtu në mbledhjet e kaluara kur i kam potencuar Rregulloret dhe Ligjet dhe kam thënë që jam një prej atyre njerëzve që të paktën i jap të drejtë vetës dhe jam shumë institucionalist në atë drejtim.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, i nderuari zotëri Çunaku, më duket se nuk më paske dëgjuar mirë sepse unë e thash që jam për rritjen e kësaj shume por vetëm të ceket nga ana juaj se ku po dëshironi t'i merrni këto mjete prej cilës kategori, sepse ne jemi që t'i ndihmojmë popullit, kështu që nëse ke dëgjuar mirë këtë e potencova. Shuma prej 60,000.00€ nëse miratohet nuk paraqet ndonjë problem edhe nëse rritet me ndonjë shumë tjetër. Pra unë mendoj se është mirë të ceket se nga cila kategori

po mendoni ju që të merren ato mjete që ju nuk po e cekni edhe pse ju jeni ata që e keni thirrë këtë seancë e që duhet ta cekni edhe kodin buxhetor prej ku të merren ato mjete në mënyrë që ta dimë ne. **z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar zotëri Maloku, unë jam përgjegjës për fjalët që i them por nuk jam përgjegjës për atë se si e kuptoni ju. Dua të them se në fillim të diskutimit tuaj pate pyetje për këshilltarët (pa dashur të hyjë në kontestimin e pyetjes sepse është e drejtë e juaja se çfarë pyetni) e që kishte ndryshim të qëndrimit sepse fillimisht pyetët ku po i merrni dhe a keni paraparë se ku po i merrni mjetet buxhetore, kurse pas tri fjalive propozuat të rritet ajo shumë buxhetore duke mos e ditur as vet ti se ku po e merr atë shumë. Prandaj në këtë kontekst e kisha fjalën kur e potencova një gjë të tillë, jo diçka tjetër.

z.Xhevdet Maloku, sërish përgjigje z.Naim Çunakut, theksoi, përgjegjësia ime nuk është se si e kupton ti po ashtu siç e mendoj unë se duhet të jetë.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, po shkelet Rregullorja e punës së Kuvendit sepse saj nuk lejohet replika mbi replikën.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit z.Naim Çunaku, edhe ju e shkelët Rregulloren e cekur sepse keni marrë fjalën më shumë se sa që lejohet.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, nuk po dëshiroj t'ju quaj me emra ashtu siç ju quajtën të tjerët, mirëpo ju them se unë nuk e shkela Rregulloren, madje edhe në një prej seancave të kaluara më ke thënë që ta lexoj Rregulloren e punës, unë e lexoj Rregulloren për vete por ti je përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje. Nuk jemi këtu në klasë të Gjimnazit apo dikund tjetër, por jemi përfaqësues të popullit sikur ti ashtu edhe unë. Unë fjalën e marrë sa herë që më lejohet me Rregullore, dhe kur flitet për zbatimin e saj nuk ka kufizim të fjalës.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, sot meqë kjo mbledhje është thirr nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së dhe me mbështetjen edhe të disa asamblistëve tjerë, dhe faktikisht vërejtëm se ka një mbështetje të të gjithëve për t'iu dalë në mbështetje kategorive me gjendje të rëndë ekonomike.

Normalisht siç jeni të informuar të gjithë, buxheti i Komunës së Podujevës rrjedh nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe nga Ligji për ndarjen buxhetore që pastaj rrjedhon tek Qarkoret Buxhetore ku në të cilat pastaj ka një kufizim të mjeteve buxhetore të cilat ndahen brenda këtyre kufizimeve, përpilohet buxheti dhe në fund miratohet në këtë Kuvend të Komunës e që buxheti për vitin 2022 është miratuar në një prej mbledhjeve paraprake të kësaj asambleje.

Buxheti i Komunës së Podujevës është mbi 23,444,000.00€, prej tyre 12,470,000.00€ janë paga, 2,650,000.00€ mallra, 420,000.00€ komunal dhe 960,000.00€ janë në kategorinë e subvencioneve. Meqë sipas këtij propozimi që po diskutojmë duhet të paguhet nga kategoria e subvencioneve vlen të ceket se Komuna e Podujevës, ne si Drejtori e Buxhetit dhe Financave dhe si Ekzekutiv në përgjithësi vazhdimisht kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Financave që të lejohet rritja e limitit buxhetor në kategorinë e subvencioneve me qëllim që të ofrojmë mbështetje për kategoritë e ndryshme për përkrahje të ndryshme buxhetore duke filluar nga fusha e arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, shërbimeve publike dhe të tjera, buxhet i cili në vitin e kaluar për subvencione ka qenë 760,000.00€ e që për këtë vit i kemi 200,000.00€ më shumë për subvencione, dhe të gjitha këto subvencione normalisht shkojnë në ndihmë financiare që kuptimi i kësaj si subvencion është ndihmë pa kthim që i'u jepen subjekteve të ndryshme qoftë fermerëve, qoftë njerëzve në nevojë, qoftë për studentëve për bursa etj, dhe nga këtu kemi rritë subvencionet nga 50,000.00€ në 100,000.00€ për bursa për studentë që ndahen në bazë të Rregullores për ndarjen e subvencioneve, do të thotë kemi dyfishim të mbështetjes financiare për studentë. Pastaj kemi një rritje nga 70,000.00€ në 100,000.00€ në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ku me këto mjete financiare mbështeten kryesisht njerëzit me sëmundje kronike me vlera financiare normalisht jo të mjaftueshme

por kaq janë mundësitë buxhetore të Komunës së Podujevës, si dhe Organizatat e ndryshme për çështje sociale siç kemi rastin e “Handikos”, por që këtë vit me një shumë të madhe do të mbështeten edhe fëmijët me probleme të autizmit.

Kemi edhe rritje të tjera të subvencioneve në fushën e ekonomisë ku do të mbështeten start-up, bizneset e grave dhe subvencione tjera ku janë të planifikuara, gjithashtu ka rritje të buxhetit për subvencione edhe në bujqësi e që në masë të madhe këto subvencione faktikisht kanë karakter social sepse mbështeten fermerë të vegjël me një mëshqerrë, me një serë të vogël ose me mekanizma të vegjël bujqësorë sepse sigurisht që subvencionet që shpërndan Komuna e Podujevës nuk aplikojnë fermerët e mëdhenj por aplikojnë kryesisht fermerët e vegjël ngase natyra e këtyre subvencioneve është e tillë ku mbështeten kryesisht fermerët e vegjël, mirëpo tek ky propozim faktikisht të gjithë po jemi për që t’i mbështesim kategoritë që janë me gjendje të rëndë ekonomike, dukshëm shihet se është kategoria më e ndjeshme pa dyshim e që u përmend se për këtë nuk duhet të bëhet politikë por këtu faktikisht kjo është puro politike dhe partiake sepse politike duhet të jetë gjithmonë mirëpo kjo është puro partiake sepse ne këtu jetojmë dhe pak a shumë është i sinkronizuar edhe me atë të para dy ditëve në nivel vendi në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku atakohet Qeveria e cila udhëhiqet nga LVV dhe këtu në Komunën e Podujevës ku atakohet qeverisja e udhëhequr nga LVV e që shumë jemi të gatshëm gjithmonë për debate dhe atakime, pra do të thotë kjo është bërë me të njëjtën logjikë sepse edhe këtu nga asamblisti z.Qëndrim Softolli u tha se po ka një neglizhim total qoftë nga niveli qendrorë qoftë nga niveli lokal, e që absolutisht nuk është e vërtetë sepse ne jemi subjekt i majt politik dhe i kemi kushtuar një rëndësi të ndjeshme kategorive sociale dhe ndarjen buxhetore për këto kategori si dhe komplet politika të majta ekonomike të cilat i kemi për nderë t’i ndjekim.

Për atë që e them unë se është politike po i jap tri argumente, dhe që ndërlidhen edhe me nivelin qendrorë, dhe atë, -para disa muajve e që ndoshta është për herë të parë në Parlamentin e Republikës së Kosovës ku hudhet një Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore për një Marrëveshje të financimit për 47 milion euro kredi për reformimin total të skemave sociale, me arsyetimin e përfaqësuesit të LDK-së i cili thotë ne nuk e mbështesim marrjen e këtyre mjeteve financiare për çështje sociale sepse në aspektin ideologjik ne jemi parti e djathtë dhe nuk na takon të merremi me këto çështje sociale, e që për mendimin tim është gabim edhe në kuptuarit e ideologjive sepse nuk do të thotë që edhe e djathta të mos i mbështetë një gjë të tillë, mirëpo në vazhdimësi keni pasë shkarje ideologjike e që disa nuk i marrin vesh fare ato punë, pastaj tjetra është -që në mbledhjen e kaluar të asamblesë komunale ka qenë një propozim vendim nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndarjen e lëndëve djegëse/dru për ngrohje për familjet me gjendje të rëndë sociale dhe nga ana e LDK-së nuk është votuar ai propozim, kurse argumenti i tretë që tregon kjo shumë shfrytëzim i ulët për çështje elektorale është se -këtë propozimin e juaj e keni gjysmak ngase në të thuhet 60,000.00€ për kategoritë sociale mirëpo ky është bilanc shumë i thjeshtë, 960,000.00€ janë për subvencione dhe kur t’i ndash 60,000.00€ dhe të destinosh ndokund natyrisht se duhet të hiqen diku tjetër dhe kjo duhet të figuroj, kurse ju nuk e bëni këtë, shembull një propozim vendim duhet të jetë i plotë dhe sikur do të sillej nga Ekzekutivi do të ishte propozim konkret ku do të shkruhej shembull, 60,000.00€ ndahen për këtë çështje, për këtë arsye dhe rrjedhimisht duhet të largohen subvencionet në DBPSHR ta zëmë, por ju doni të thoni, ne i mbështesim rastet sociale me 60,000.00€ ndërsa LVV po i zvogëlon subvencionet në bujqësi ose kulturë rini sport apo në ekonomi. Do të thotë i keni tri argumente të qarta që tregojnë ashiqare se janë politikë e që unë po besoj se nuk është njerëzore që të përdoren çështjet që janë tejet sociale. Edhe njëherë e përsërisë që ne kemi bërë përpjekje të vazhdueshme e që është një rritje e madhe e subvencioneve për 200,000.00€ nga të cilat kemi kategori të cilat dyfishohen me buxhet siç është

kategoria e bursave për student apo rritje shumë e madhe në kategorinë e Shëndetësisë, mirëpo edhe te zhvillimi ekonomik apo te çështjet ekonomike të cilat edhe janë të ndërlidhura me çështje sociale sepse në radhë të parë duhet të kemi zhvillim që pastaj të kemi një gjendje të mirë sociale e që ne jemi 22 vite pasluftës dhe që e kemi këtë gjendje ekonomike dhe tani ndoshta një subjekt politik që na vie me këtë propozim por që i cili ka faje direkte për de-industrializimin e vendit, qoftë në bordin e AKP-së qoftë nga çështjet komunale kemi disa fabrika të shkatërruara në Komunën e Podujevës të cilat sot janë të mbyllura apo që janë kthyer në shitore e që ka edhe zyrtar të lartë të LDK-së që janë të arrestuar ashtu siç ka edhe njerëz të Komunës që janë arrestuar, kurse tani po na vika propozim për çështje sociale, me dy litra vaj, andaj ndoshta termi i duhur është hipokrizi por vërtetë kjo është absurditet. Do të thotë keni dorë në de-industrializimin e vendit, të asaj pak industrie që ka qenë në këtë vend të cilën e keni shkatërruar, ndërsa atyre punëtorëve që kanë qenë në ato fabrika jeni bërë shumë humanitar dhe po dëshironi t'ju jepni dy litra vaj, politikat ekonomike të cilat i keni ndjekë komplet na kanë prurë në këtë situatë, ata njerëz të cilët e kanë varfëruar këtë vend janë edhe përgjegjës për këtë.

Edhe në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është një informatë e që ne mund ta dimë edhe nga përditshmëria, por unë jam shokuar kur kam dëgjuar se është një mori i rasteve ku familja, madje edhe personat e rinj, kërkojnë ndihmë sociale në këtë Drejtori, e që kjo situatë shokuese nënkupton se që tri gjenerata ballafaqohen me këto probleme elementare dhe ku ka qenë qeverisja qendrore dhe ajo lokale që t'i adresoj në mënyrë reale këto probleme.

Politikat sociale janë goxha komplekse dhe nëse i thjeshtëzojmë në dy litra vaj është absurde, por kjo është problematikë në aspektin më të gjerë, mirëpo si do që të jetë këtu jemi para një propozimi që të ndahen mjete buxhetore në shumë 60,000.00€ për mbështetjen e tyre për çka ishte vullneti i të gjitha Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit që të mbështetet ky propozim, mirëpo nga propozuesi duhet të specifikohet dhe a dëshironi t'i specifikoni dhe a duhet të specifikohet nga cilët programe duhet të merren ato mjete buxhetore, apo vetëm ta cekni në propozim se këto mjete duhet të merren nga kategoria e subvencioneve dhe pastaj të mbetet në diskrecion të Ekzekutivit të Komunës se nga ku duhet të merren ato mjete buxhetore, por propozim vendimi i plotë duhet të specifikoj edhe pjesën se nga cilët programe buxhetore duhet të merren ato mjete.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, dua që në pika të shkurtra të ndërlidhem me atë që drejtori parafolës e potencoj e që e falënderoj për raportin që e bëri gjerë dhe gjatë.

Sa i përket asaj që e tha se dje jemi atakuar në Kuvendin e Republikës së Kosovë, i them se nga ata që është atakuar dje sot jeni duke bashkë qeverisur këtu në Komunë, dhe fundja ne jemi të thirrur dhe të zgjedhur për politika lokale, jo ato qendrore.

Sa i përket kredisë për skema sociale, të lutem drejtor mos e fol më atë sepse nuk e di se si e arsyeton pastaj dhe nuk e di se si e logjikoni ju këtë, ndërsa në anën tjetër fole për projekte për zhvillim të vendit ndërsa unë nuk e di si zhvillohet vendi me kredi për skema sociale, me çfarë logjike bëhet kjo. E përgëzoj drejtori parafolës për përgatitjen duke u bazuar në atë që e tha se është kalkulim dhe po të ishte shumë më e madhe do të futesha në siklet, mirëpo i nderuar drejtor nga 960,000.00€ nuk po je në gjendje t'i ndash 60,000.00€ për këtë qëllim. Pastaj drejtori e përmendi shprehjen absurditet duke cekur dy litra vaj, por që para tri – katër ditëve kushtonin 7 € e që për juve ndoshta nuk janë shumë e madhe por për shumicën e familjeve kosovare është mjaft.

Politikën e bëtë ju sepse në parim të gjithë deklaroheni se po e përkrahim, por atë që e potencuat ishit komplet kundër e që fare nuk më pëlqeu, dhe besoni se na kanë përcjellë dhe dëgjuar qytetarët dhe i kanë dëgjuar gjitha këto diskutime prej të zgjedhurve të tyre për diçka që është si kategori më e ndjeshmja, pra jemi duke diskutuar për listën e familjeve me asistencë sociale dhe në nevojë dhe e

dini shumë mirë sa është e nevojshme kjo çështje, ndërsa drejtori përmendi shumë projekte dhe subvencione tjera mirëpo unë nuk e di cila është më me prioritet se kjo që po diskutojmë.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, theksoi, ne përfaqësojmë ide politike dhe arsyetimi përse është refuzuar të votohet Marrëveshja për kredia me Bankën Botërore është se LDK ka thënë se ne jemi parti e djathtë dhe nuk merremi me çështje sociale, do të thotë janë dy probleme këtu, ata që e thonë atë nuk e kuptojnë të djathtën dhe të majtën fare, kurse e dyta ju flisni kundër një Marrëveshje me Bankën Botërore që ka pas të bëjë me komplet reformimin e skemave sociale e që në Kosovë janë problematike dhe duhet një reformim i thellë dhe normal ai ka qenë program i Bankës Botërore e që nuk caktojmë ne projekte të Bankës Botërore por kemi disa limite buxhetore qoftë në nivel lokal qoftë në nivel qendrorë dhe janë disa programe të cilat i ndjekin Organizata Ndërkombëtare e që varet se a dëshirojmë që të aplikojmë në ato programe e normalisht ka qenë interesim që të reformohen skemat sociale dhe në këtë aspekt ka qenë kredi e butë dhe pothuajse pa interes fare e që gjithëherë është e leverdishme të merren kredi të tilla sepse ato 47 milion do të alokoheshin për reformim të skemave sociale ndërsa në anën tjetër liron mjetet buxhetore të vendit që kanë qenë të parapara për atë kategori dhe të njëjtat i orienton për projekte prioritare qofshin ato për arsim, shëndetësi etj, e që po besoj se kjo është logjikë shumë e thjeshtë, mirëpo arsyeshmëria juaj ka qenë se jemi të djathtë, dhe për këtë sërish po e them se është një kalkulim shumë i thjeshtë financiar që në fund shtetit i del e leverdishme të merret ajo kredi sepse mjetet aktuale pastaj i dërgon diku tjetër, prandaj mos tentoni ta arsyetoni këtë sepse nuk ka arsye.

Çështja tjetër, të gjithë e ceken se mbështet ky propozim por unë i ceka argumentet e mia që përse këtë e keni bërë thjesht për çështje politike si dhe e argumentova se ne kemi një rritje shumë të madhe në kategorinë e subvencioneve, madje drejtori i DSHMS mund t'ju tregoj që vetëm vitin e kaluar janë jep ndihma të ndryshme rreth 400,000.00€ nga donatorë të ndryshëm për njerëz të cilët kanë gjendje jo të mirë ekonomike e që fatkeqësisht janë shumë dhe që të gjithë e dinë se si ka ardh deri te kjo gjendje e rëndë ekonomike në gjithë Kosovën dhe ndoshta me theks të veçantë në Komunën e Podujevës, këtu keni qeverisë për 20 vite, atje keni qenë kryesisht në qeverisje, e keni sjellë këtë vend në këtë situatë, kurse ne po bëjmë përpjekje çdo ditë që të dalim nga kjo situatë, mirëpo nuk dilet me këto propozime të cilat janë thjesht elektorale por që sërish ne e mbështesim sepse megjithatë konsiderojmë se duhet mbështeten familjet me gjendje jo të mirë ekonomike, ashtu siç është mbështetja nga të gjithë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori parafolës po më duket se i'u ka përzier detyra, përndryshe të shkoj ministër në nivel qendrorë. T'i drejtor po na tregon se cilat parti në nivel qendror po punojnë dhe cilat jo. Ju edhe kundër pavarësisë keni qenë. Numrat i keni në Parlament dhe kaloni ato çështje e mos na tregoni këtu neve për nivel qendror sepse ne jemi nivel lokal, por sot ju paska përzier paksa drejtorit të DBF.

z.Naim Çunaku, theksoi, drejtori i DBF-së si përfaqësues apo si njeri kompetent për të gjetur zgjidhje për mjetet buxhetore, si Ekzekutiv i Komunës të na bartë këtu politikën e nivelit qendrorë dhe të akuzon për gjendjen e krijuar në Kosovë duke potencuar që 22 vite në adresa ku bëri një ndarje të djathtëve dhe të majtëve në skenën politike Kosovare duke tërhequr një paralelizëm, e që e vërteta e madhe është se në skenën politike në Kosovë si subjekte më të vogla i kemi vetëm 2 socialdemokrate dhe gjitha të tjerat janë të djathta, dhe në qeverisjen gjegjësisht në ndërtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës deri këtu ku jemi kanë marrë pjesë dhe kanë qenë pjesëmarrës gjithkush në rolin tij, LDK, PDK, AAK dhe Nisma Socialdemokrate, dhe për të gjitha këto parti që në këtë seancë po tentohet të na bartet këtu, të gjitha e dinë pozicionin e tyre karshi “bërjes sehire” të atyre që janë përgjegjës.

E thash edhe më parë dhe po e përsërisë se nuk do të doja të vijmë këtu ku erdhëm nëse ndokush mendon që duke i fajësuar të tjerët për gjendjen këtu në Komunën e Podujevës dhe për gjendjen në Kosovë nuk bënë diçka tjetër, vetëm bëhet bashkëfajtor me ata.

U përmenden njerëz të akuzuar, njerëz me vepra sidomos në shkatërrimin e ekonomisë Kosovare, kur dhe kush duhet të veproj për ato informata që i ka në adresa të caktuara të individëve të caktuar, cilido grupim politikë qofshin ata qoftë edhe të LDK-së që i takoj unë por edhe partive tjera që veprojnë në Kosovë, nëse sot ata që janë përgjegjës i identifikojnë ata persona dhe i dërgojnë atje ku e kanë vendin. Nuk jemi duke e mbrojtur ne askënd që e ka shkatërruar apo që është duke e shkatërruar vendin dhe ardhmërinë tonë, kushdo qofshin ata dhe me çfarëdo ngjyrash politike qofshin, qofshin të majtë qofshin të djathtë.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, unë e kam propozim vendimin të cilin mund ta lexoj apo t'ju jap juve i nderuar Kryesues që ta lexoni, pastaj të hedhet në votim sepse nuk kemi çfarë të diskutojmë më këtu për këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne vetëm po presim mos rastësisht po ka ndonjë propozim tjetër.

z.Kasib Bashota, theksoi, nga diskutimet po shihet se të gjithë kanë vullnet për t'i ndihmuar familjet në nevojë dhe dëshira është e të gjithëve por mundësitë janë të kufizuara.

Nga Grupi propozues është dashtë të tregohet se nga cila kategori të tërhiqen mjetet buxhetore, përndryshe duhet t'i kalohet drejtorit të DBF-së në përgjegjësi se ku të sheh më të arsyeshme t'i marrë mjetet buxhetore prej 60,000.00€ dhe të ecet përpara. Pra nuk po shohë që ndokush është kundër kësaj çështje.

z.Haki Rudari, theksoi, dëgjova me vëmendje diskutimet e të gjithë parafolësve, por kryesisht ndoshta ato të opozitës LDK të cilën e kuptoj mirë sepse kam qenë opozitë një kohë të gjatë dhe mjaft shumë kam heqë, pra e kuptoj plotësisht por në të njëjtën kohë aty ku nuk është në rregull natyrisht se nuk do të jemi në nivel me ata.

Kam kërkuar në të kaluarën mbledhje të jashtëzakonshme dhe për këtë edhe kolegu këtu z.Naim Çunaku është në dijeni, por e kam thirr edhe shefin e Grupit të këshilltarëve të LDK-së në atë kohë, do të thotë për një ide apo propozim konkret kur nuk e ke për diçka elektorale dhe për vota i'u propozon dhe i thirr të gjithë përfaqësuesit e Grupeve politike, dhe zotëri Çunaku e dinë këtë.

Prandaj kërkesa e juaj në parim përkrahet, por nuk përkrahet kështu siç është sepse e keni për politikë e që mendoj se nuk bëhet politikë për pako me 60,000.00€, por në të njëjtën kohë ku t'i marrësh këto mjete serish jetë keq diçka edhe pse u tha këtu se po bëhet për të mirë dhe ashtu është, dhe në të njëjtën kohë Drejtoria përkatëse kudo që i merr ato mjete nëse kalon ky propozim lë keq këtë ta dini dhe pastaj mos thoni se arsimi është keq, bujqësia është keq, zhvillimi ekonomik, kultura rinia dhe sporti janë keq, prandaj nuk bëhet shumë fushatë dhe nuk mund merr vota në këtë formë, qytetarët kanë votuar dhe qytetarët janë të vetëdijshëm për secilin veprim të çdokujt që merret.

Dikush po dëshiron të thotë se jo nuk ka udhëheqë askush këtu, por e vërteta është se këtu për 18 vite ka udhëheqë LDK, dhe po të udhëheqte mirë sigurisht se sot do të ishim në opozitë, por qytetarët e kanë parë se LDK nuk mund të udhëheqë më, vijnë zgjedhjet tjera dhe jemi gjithçka në rregull, prandaj edhe njëherë e them se kërkesa e LDK-së që në parim po përkrahet, por kur ta analizosh më në detaje gjenë shumë politikë këtu. Kjo është ajo pjesa që unë u mundova ta them se është politike kjo dhe nuk është në rregull kështu.

z.Naim Çunaku, theksoi, me parafolësin njihemi dhe tani është mandati i dytë që jemi së bashku anëtar të Kuvendit. E përkrahi dhe pajtoj idenë që për çdo iniciativë në rend të parë është dashtë ne si anëtar të Kuvendit pavarësisht ngjyremeve politike iniciativat t'i mbështetnim kur janë të thirrura për qytetarët. Kolegu z.Haki Rudari por edhe unë jemi në dijeni për bashkëpunimin që kemi pasë në mandatin tjetër të kaluar që kemi qenë në këtë Kuvend e që nuk po dëshiroj të hyjë në detaje, por për këtë apelin e zotëri Rudarit e që unë e mbështesë që të bashkëpunojmë të gjithë së bashku për të mirë të qytetarëve po e them vetëm një çështje, zotëri Haki Rudari kujtoje seancën e 28 shkurtit të këtij viti dhe kush i rrënoj këto ura bashkëpunuese, madje e kam thënë dje në KPF dhe po e përsërisë edhe këtu që për herë të parë kur LVV si parti është përfaqësuar në këtë Kuvend dhe ka pasë vetëm 3 përfaqësues, që të tre ata përfaqësues kanë qenë të përfaqësuar nëpër komisione dhe komitete, ndërsa çka ndodhi më 28 shkurt 2022, kush dhe përse i rrënoj këto ura.

z.Haki Rudari, theksoi, i nderuar Çunaku mund ta përcjellësh diskutimin tim në mbledhjen e 28 shkurtit 2022 dhe mund ta shikosh propozimin tim që ka qenë, mirëpo ju keni abstenuar nga propozimet dhe që ju keni refuzuar të jepni propozime është faji juaj. Nëse nuk është kështu siç e ceka mund ta shikosh transkriptin e mbledhjes ku ju në rastin e parë keni propozuar kurse në rastet tjera keni heq dorë prej propozimeve dhe votimit, andaj për atë çështje është gabimi juaj, jo i joni.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i LVV-së propozojmë që shumta e mjeteve buxhetore të jetë 70,000.00€ në mënyrë që t'iu ndihmohet kategorive të familjeve në nevojë dhe me asistencë sociale, kështu që mendojmë se është mirë të hedhet në votim si propozim që e paraqita.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, unë mendoj se përgjegjësinë kryesore për këtë çështje duhet t'ia lëm drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në mënyrë që të mos lihet keq asnjë kategori e subvencioneve, që të rishikohet në tërësi se ku duhet të tërhiqen mjetet buxhetore.

Nuk besoj se drejtori i DBF-së duhet të merret me orientime politike, majtas e djathtas sepse së pari Kryetari i tij dhe shumica e të tjerëve kanë qenë djathtist në jetën e tyre ndërsa sot nuk po di se si ti quaj ata, majtist apo "miksistë".

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa po vërej ju zotëri Softolli po dëshironi ta përmbyllni fjalën për këtë seancë, mirëpo ta shikojmë se a dëshiron fjalën ndokush tjetër para se të marrësh ti si iniciues i kësaj mbledhje.

z.Driton Veliu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, kërkesa e juaj për këtë seancë të jashtëzakonshme me qëllim të dhënies së ndihmave me pako ushqimore dhe higjienike për familjet me asistencë sociale dhe në nevojë, është e mirëseardhur për DSHMS, Drejtori kjo e cila sipas specifikave merret me këto kategori dhe kemi një përvojë tashmë 1 vit e gjysmë në këtë drejtim. Gjendja socio-ekonomike në Komunën e Podujevës padyshim se është tepër e rëndë dhe zyrtarisht kemi 957 familje me asistencë sociale, mirëpo gjendja reale është shumë më e keqe, do të thotë kemi edhe familje tjera të cilave i'u ndërpritet asistencë sociale për arsye ligjore, shembull tek familjet ku fëmija më i vogël ka më shumë se 5 vite asaj familje i ndërpritet asistencë sociale e që gjendja ekonomike e atyre familjeve nuk është rregulluar si kundër gjendja e tyre bëhet edhe më e vështirë, mirëpo ne si DSHMS i kemi investiguar kërkesat dhe përvojat e njëjta të kaluara duke ndikuar që subvencionet prej 70,000.00€ sa e kemi trashëguar t'i rrisim në 100,000.00€ duke marrë për bazë limitet buxhetor e që është rritur kjo kategori me 42% të buxhetit në raport me vitet e kaluara.

Prej shumës 100,000.00€ për subvencione që kemi ne si DSHMS i kemi orientuar në kategoritë që janë shumë më të ndjeshme, fjala është për dy kategori të mëdha, ku për kategorinë e parë kemi ndarë një shumë prej 80,000.00€ që përfshinë pacientët e shumtë që janë në Komunën e Podujevës të cilët vuajnë nga sëmundjet shumë të rënda serioze siç është karcinomat, tumore të ndryshme, sëmundje kronike me faza të avancuara dhe sëmundje tjera të trashëguara, të lindura etj, dhe po

ashtu dëshiroj t'ju njoftoj se vetëm gjatë muajit janar të këtij viti Komisioni përkatës i cili merret me shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për subvencionim të barnave deri tani i kemi ndarë 18,000.00€, pra kemi kërkesa jashtëzakonisht të shumta, jemi në dijeni se gjendja e tyre sociale është shumë e rëndë dhe jemi të vetëdijshëm se përveç që pagat dhe të hyrat e atyre që marrin asistencë sociale nuk kanë ndryshuar, kriza globale, epidemia dhe shumë faktorë tjerë të jashtëm dhe të brendshëm duke përfshirë edhe qeverisjet e këqija të juaja gjatë vetive të kaluara, ka ndikuar që gjendja veç sa të rëndohet.

Pastaj pjesa tjetër prej 20,000.00€ të subvencioneve do t'ju ndahet OJQ-ve të ndryshme të cilat operojnë në Komunën e Podujevës duke përfshirë edhe OJQ-në “Handikos” për të cilën planifikojmë që gjatë këtij viti fiskal t'i ndahen rreth 12,000.00€, madje për herë të dytë do të ndajmë një shumë të konsiderueshme të mjeteve buxhetore për një shkollë që merret me trajtimin e pacientëve konkretisht qytetarëve/fëmijëve me autizëm e që aktualisht numri i tyre është rreth 20 por që realisht numri i tyre pritet të rritet sepse një numër i madh i familjeve të Komunës së Podujevës fëmijët e tyre i dërgojnë për trajtime psikologjike në Prishtinë, por që ne shpresojmë se me këtë shumë mbi 10,000.00€ do t'iu mundësohet shumë familjeve të Komunës së Podujevës të cilat kanë probleme të tilla me fëmijët e tyre që të bëjnë trajtimin dhe vazhdimin e rregullt të seancave në mënyrë që sa do pak t'iu hiqet barra financiare atyre familjeve për problemet që kanë me fëmijët e tyre.

Gjithashtu ne do të subvencionojmë edhe Organizata të tjera të cilat merren me trajtimin por edhe me shumë probleme tjera që i'u përgjigjen qytetarëve të Komunës së Podujevës. Do të thotë ne si DSHMS nuk mund të heqim mjete nga buxheti jonë sepse pastaj i lëm keq shumë kategori tjera të pa përfshira siç është rasti i atyre me sëmundje të rënda, në rast se shuma prej 60,000.00€ apo 70,000.00€ merret nga DSHMS.

U përmend nga propozuesi se nga qeverisja lokale është neglizhuar kjo punë kinse nuk kemi punuar mjaftueshëm për rastet me asistencë sociale dhe jo vetëm, mirëpo unë ju njoftoj se në Komunën e Podujevës gjatë vitit të kaluar DSHMS ka arritur që në bashkëpunim me donator të ndryshëm ka arritur të shpërndaj afërsisht 400,000.00€ donacione. Edhe këtë vit jemi duke negociuar me donator të ndryshëm dhe presim që gjatë Muajit të Ramazanit të marrim një pako të madhe të ndihmave të cilat do t'iu adresohen familjeve me asistencë sociale dhe jo vetëm, ku përfshihen edhe familje të tjera që kanë probleme të rënda shëndetësore.

Gjithashtu njoftoheni se ne jemi në kontakt edhe me donatorë të tjerë që janë qytetarë të Komunës së Podujevës të cilët janë të pasur dhe që janë të gatshëm të vazhdojnë me donacione për familje të ndryshme në Komunën e Podujevës. Nëse keni ndonjë pyetje rreth mirëqenies sociale, jeni të mirëseardhur.

z.Arjant Topanica, theksoi, një koment të shkurtër dua të bëjë sepse qysh u fol këtu nga disa që për 20 vite dëme shkatërrime dhe atë që është bërë, po të ishte ndokush që na dëgjon dhe që nuk ka shumë njohuri për Kosovën dhe ngjarjet me siguri do të thoshte që LDK e paska fajin edhe për pandeminë e madje edhe për luftën në Ukrainë, por ndoshta kjo është arsyeja e juaj e vetme dhe arma me të cilën luftoni dhe e mbuloni atë çfarë mundeni dhe dini ta bëni kur vet jeni përgjegjës.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, unë edhe në fjalën hyrëse si iniciues e ceka që shuma e mjeteve buxhetore e propozuar është e vogël dhe e pamjaftueshme dhe që e përkrahim çfarëdo shume tjetër, mirëpo çka u diskutua dhe çka u tha deri tani, atëherë ku mbeti rëndësia e kësaj mbledhje. Nuk e di përse po i'u dhembë aq shumë, kjo është vetëm nisma e parë prej anës tonë sepse ne do të vazhdojmë kështu, andaj merrni mësim.

Tani do të doja të dija nga znj.Adelinë Stublla se meqë ajo propozoj një shumë tjetër, a e gjeti vendin e tërheqjes së mjeteve sepse na keni mbytur duke vajtuar si në KPF ashtu edhe sot në këtë mbledhje

duke thënë ku po merren mjetet. Normalisht e përkrahim rritjen e shumës buxhetore të propozuar nga znj. Adelinë Stublla.

znj. Adelinë Stublla, përgjigje parafolësit, theksoi, përderisa e di për ata edhe e bëra propozimin, kështu që kjo është arsyeja.

z. Qëndrim Softolli, theksoi, ne duhet ta dimë propozim vendimin në mënyrë që të jemi në dijeni se çka do të votojmë pastaj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne tani kemi dy propozime, kryesisht rreth shumës së mjeteve buxhetore, propozimin e Grupit të LDK-së dhe atë të Grupit të LVV-së, kështu që unë mendoj se nuk kemi çfarë diskutojmë më shumë rreth kësaj teme vetëm mbetet që t'i hedhim në votim.

z. Qëndrim Softolli, theksoi, i nderuar Kryesuesi i Kuvendit, propozimi është vetëm një dhe seanca është thirr vetëm me një pikë të rendit të ditës, prandaj propozimi tjetër ishte vetëm për rritjen e shumës por jo për propozim të ri.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuar Softolli as ju në kërkesën për këtë seancë nuk keni cekë shumë buxhetore e që kur keni caktuar pikën e rendit të ditës keni mund ta cekeni një shumë të mjeteve financiare. Prandaj shumën e cekët në KPF, kurse znj. Adelinë Stublla tani e propozoi këtu shumë tjetër, prandaj meqë janë dy propozime duhet të hedhen në votim veç e veç.

z. Qëndrim Softolli, theksoi, unë shumë qartë e ceka në fillim të kësaj mbledhje në fjalën iniciues se çdo rritje të shumës së propozuar që mund të bëhet ne e përkrahim, andaj mund të jepen propozime vetëm për rritjen e shumës buxhetore, ndërsa propozim vendimi është i joni sepse sipas tij është thirr kjo seancë. Pra edhe njëherë, nuk mund të jenë dy propozim vendime, mund të jenë dy propozime vetëm për shumën e mjeteve buxhetore, andaj propozimin tonë duke i'a shtuar edhe shumën e propozuar e që në total bëhet 70,000.00€ vetëm e hedh në votim dhe gjithçka është në rregull pastaj. Përndryshe ne mund të propozojmë në pafundësi shuma të ndryshme, madje mund t'ia shtojmë tani edhe 1000€ e kështu me radhë. E them këtë sepse konsideroj se kjo çështje u politizua skajshmërisht.

(Në kërkesë të drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, vetëm sa për informim, këshilltarëve të Kuvendit i'u shpërndahet një informatë në formë të shkruar në të cilën figurojnë ndihmat/donacionet e shpërndara për qytetarët e Komunës së Podujevës gjatë vitit 2021).

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani ftoj iniciuesin e kësaj seance që ta paraqes/lexoj propozim vendimin në mënyrë që pastaj të hapet mundësia për ta hedh në votim.

z. Qëndrim Softolli, në cilësinë e iniciuesit paraqiti propozimin përkatës si në vijim, propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare, -(neni 1) ndahen mjete financiare në shumë 60,000.00€ ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe higjienike në territorin e Komunës së Podujevës për shkak të situatës së krijuar nga rritja e vazhdueshme e çmimeve dhe produkteve bazike. -(Neni 2) mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve. Pastaj nenet vijuese,

-Mjetet e ndara sipas këtij neni do t'iu kompensohen Drejtorive ose Drejtorisë përkatëse nga të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin 2021, dhe kjo si mundësi.

-Implementimi i këtij vendimi bëhet sipas procedurave të prokurimit publik.

-Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

-Neni vijues që rregullon hyrjen në fuqi të këtij vendimi që është 7 ditë pas publikimit.

Po ashtu si Grup i LDK-së mbështesim propozimin e LVV-së për rritjen prej 10,000.00€ të shumës së propozuar në fillim të kësaj seance, që në total shuma është 70,000.00€.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozimin vendimin paraprak duke përfshirë edhe propozimin për rritjen e shumës edhe për 10,000.00€ që shuma totale që ndahet për ndihmë qytetarëve në nevojë, me pako ushqimore dhe higjienike të jetë 70,000.00€, si dhe çështje tjera relevante të parapara në propozim vendimin përkatës të cilin iniciuesi do ta dorëzoj edhe në formë fizike tek shërbimi përkatës përmes Kryesuesit të Kuvendit.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, njëzëri (me 33 vota PËR) miratohet propozimi, përkatësisht merret vendim për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 70,000.00€, ndihmë qytetarëve në nevojë, me pako ushqimore dhe higjienike, në territorin e Komunës së Podujevës, për shkak të situatës së krijuar nga rritja e vazhdueshme e çmimeve të produkteve bazike.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, si pjesë të kësaj teme/pike, në fillim të mbledhjes në fjalën hyrëse e kam kërkuar që në rast të miratimit të këtij propozim vendimi, të ngritët e dhe një komision për mbikëqyrjen e procesit të shpërndarjes së pakove, dhe atë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, do të ishte mirë të konsultoheshim lidhur me këtë propozim për ngritjen e komisionit në fjalë, konkretisht a mund ta ngritë Kuvendi i Komunës apo t'i lihet Ekzekutivit të Komunës që ta ngritë.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa për sqarim i nderuar Kryesues, në bazë Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Statutit të Komunës, Kuvendit të Komunës i lejohet të ngritë komisione ad-hoc të cilat përcjellin një punë, një projekt, në këtë rast një implementim të kësaj iniciative, dhe kjo çështje këtu përfundon. Andaj nuk kemi çfarë ta konsultojmë askënd për këtë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne jemi në dijeni se Drejtoritë përkatëse dhe Zyra e Prokurimit i kryejnë ato çështjet, mirëpo meqë doli si propozim që të ngritët një komision ad-hoc i cili do të ketë për detyrë vetëm të shikoj procesin e shpërndarjes së pakove. Kështu që urdhëroni paraqiteni propozimin konkret.

z.Naim Çunaku, theksoi, do të ishte mirë që paraprakisht ta vendosim se sa anëtar do t'i ketë komisioni e pastaj të japim propozimet e emrave.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, do të propozoja që në atë komision të përfshihen të gjitha subjektet politike përfaqësuese në këtë përbërje të Kuvendit.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, propozoj që komisioni të përbëhet prej 5 anëtarëve duke u përfshirë të gjitha subjektet politike.

Njëzëri përkrahet propozimi që komisioni ad-hoc sipas propozimit përkatës të përbëhet prej 5 anëtarëve dhe atë nga të gjitha subjektet përfaqësuese në këtë përbërje të Kuvendit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani ftoj të jepen propozimet konkrete të emrave për anëtar në këtë komision.

znj.Donjetë Sheqiri, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LDK-ës propozoi znj.Edona Shabanin.

znj.Adelinë Stublla, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LVV-së propozoi z.Ardi Hasanin.

z.Bashkim Sylja, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të PDK-së propozoi znj.Endritë Muratin.

z.Arbnor Fazliu, nga radhët e Grupit të AAK-së propozoi z.Burim Hasanin.

Kryesuesi i Kuvendit, meqë këshilltari i Kuvendit nga radhët e OBKD mungon, por që paraprakisht u përkrah propozimi që pjesë e komisionit në fjalë të jenë nga të gjitha subjektet politike atëherë i bie që edhe z.Gazmend Islami të jetë në Komision.

z.Qëndrim Softolli, paraqet propozimin, theksoi, kërkojmë krijimin e komisionit ad-hoc në përbërje miks nga subjektet e Kuvendit të Komunës, i cili do ta mbikëqyrë procesin dhe do të hartoj raport i cili në fund të procesit do t'i raportoj Kuvendit të Komunës (fjala është për procesin e shpërndarjes së pakove).

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush ka diçka për të shtuar, nëse jo atëherë e hedh në votim ngritjen e komisionit ad-hoc për mbikëqyrjen e procesit të shpërndarjes së pakove ndihmë për familjet me asistencë sociale dhe në nevojë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, njëzëri (me 33 vota PËR) miratohet propozimi si pjesë e kësaj pike dhe vendimit paraprak, përkatësisht merret vendim për ngritjen e komisionit ad-hoc nga Kuvendi i Komunës, për mbikëqyrjen e procesit të shpërndarjes të pakove ushqimore dhe higjienike, ndihmë familjeve në nevojë, në këtë përbërje;

Edona Shabani, nga radhët e LDK

Ardi Hasani, nga radhët e LVV

Endritë Murati, nga radhët e PDK

Burim Hasani, nga radhët e AAK

Gazmend Islami, nga radhët e OBKD

z.Qëndrim Softolli, theksoi, për fund dëshiroj t'i falënderoj të gjithë për mbështetjen e dhënë.

Nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:25

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0019628/22

Podujevë,

16 mars 2022

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha